



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 23.5.2023

Nr: 554

Ora: 15:00

VENDIM
PËR

**SHPËRNDARJEN E MANDATEVE NDËRMJET SUBJEKTEVE ZGJEDHORE PËR KËSHILLIN E BASHKISË
TEPELENË, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023**

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronja "i", e 2, nenit 162 dhe nenit 166, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

VËREN:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronja "i", të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve miraton shpërndarjen e mandateve në zgjedhjet për këshillat vendorë, si dhe jep mandatet për çdo kryetar bashkie, territori i të cilave është ndarë në më shumë se një ZAZ.

Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor, me vendimin nr. 78, datë 15.5.2023, ka miratuar Tabelën Përmbledhëse të Rezultatit për Këshillin e Bashkisë Tepelenë. Kundër vendimit të sipërcituar të KZAZ-së nuk rezultojnë të jetë bërë ankime brenda afateve ligjore.

Në bazë të nenit 162, pika 1, dhe 166, pika 3, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve përllogarit shpërndarjen e mandateve për çdo zonë zgjedhore.

Rezultati për subjektet zgjedhore për Këshillin e Bashkisë Tepelenë pasqyrohet në tabelën nr.1, në vijim:

(Tabela nr.1)

Nr. FV	Subjekti Zgjedhor	Vota	Përqindja
1	Bashkë Fitojmë	426	8,68 %
2	Partia Socialiste e Shqipërisë	2680	54,58 %
3	Partia Agrare Ambjentaliste e Shqipërisë	185	3,77 %
4	Partia Republikane Shqiptare	358	7,29 %
5	Partia Lëvizja e Legalitetit	72	1,47 %

Data: 23.5.2023 Nr: 554
Ora: 15:00



"Për shpërndarjen e mandateve ndërmjet subjekteve zgjedhore për Këshillin e Bashkisë Tepelenë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023"

6	Partia Demokracia Sociale	42	0,86 %
8	Partia Socialdemokrate	400	8,15 %
9	Partia Demokratike	227	4,62 %
12	Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet	44	0,90 %
17	Aleanca Arbnore Kombëtare	189	3,85 %
18	Partia Balli Kombëtar	150	3,05 %
19	Aleanca për Demokraci dhe Solidaritet	137	2,79 %
	Totali	4910	100 %

Në bazë të nenit 162, pika 2, numri i votave të vlefshme në nivel zone zgjedhore të secilit subjekt pjesëtohet në mënyrë të vazhdueshme me numra natyrorë të njëpasnjëshëm, të quajtur pjesëtues, duke filluar me numrin 1 dhe duke përfunduar me numrin natyror 15 (pesëmbëdhjetë) që i korrespondon numrit të mandateve që shpërndahen në zonën zgjedhore Bashkia Tepelenë, në bazë të shkresës nr. 198/1 Prot., datë 27.02.2023, të Prefektit të Qarkut Gjirokastrë.

Herësit e përfituar nga ky pjesëtim janë në tabelën nr. 2 , që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Sipas nenit 162, pika 4, herësit e përftuar nga çdo pjesëtim, renditen në listë nga herësi më i madh tek ai më i vogël, duke renditur përkrah tyre subjektin, të cilit i përket herësi përkatës. Renditja vazhdon derisa të renditen aq herës sa është numri i mandateve që shpërndahen në zonën zgjedhore përkatëse, pra 15 (pesëmbëdhjetë). Nga kjo renditje marrim rezultatin e pasqyruar në tabelën nr. 3, në vijim:

(Tabela nr.3)

Nr.	Herësi	Subjekti
1	2680	Partia Socialiste e Shqipërisë
2	1340	Partia Socialiste e Shqipërisë
3	893	Partia Socialiste e Shqipërisë
4	670	Partia Socialiste e Shqipërisë
5	536	Partia Socialiste e Shqipërisë
6	446	Partia Socialiste e Shqipërisë
7	426	Bashkë Fitojmë
8	400	Partia Socialdemokrate
9	382	Partia Socialiste e Shqipërisë
10	358	Partia Republikane Shqiptare
11	335	Partia Socialiste e Shqipërisë
12	297	Partia Socialiste e Shqipërisë
13	268	Partia Socialiste e Shqipërisë
14	243	Partia Socialiste e Shqipërisë
15	227	Partia Demokratike

Në bazë të nenit 162, pika 5, të Kodit Zgjedhor, një subjekt zgjedhor përfiton një numër mandatesh të barabartë me numrin e herësve të përfshirë në listën e përcaktuar në tabelën nr. 3.

Nga kryerja e veprimeve të mësipërme marrim rezultatin për shpërndarjen e mandateve të pasqyruar në tabelën nr. 4, në vijim:

(Tabela nr. 4)

Nr.	Subjekti Zgjedhor	Mandate
1	Bashkë Fitojmë	1
2	Partia Socialiste e Shqipërisë	11
3	Partia Republikane Shqiptare	1
4	Partia Socialdemokrate	1
5	Partia Demokratike	1

Sipas nenit 163, pika 1 dhe të nenit 166, pika 3, të Kodit Zgjedhor, menjëherë pas përfundimit të llogaritjes së rezultatit si më sipër, KQZ-ja përlllogarit shpërndarjen e mandateve për kandidatët fitues për secilin subjekt, në bazë të renditjes në listat shumëmemërore të subjekteve zgjedhore të miratuara nga KZAZ-ja.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pikat 1, shkronja "i", e 2, nenin 162 dhe nenin 166, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar,

VENDOS:

- Shpërndarjen e mandateve për subjektet zgjedhore në zonën zgjedhore Bashkia Tepelenë, si më poshtë:

Subjekti Zgjedhor	Mandate
Bashkë Fitojmë	1
Partia Socialiste e Shqipërisë	11
Partia Republikane Shqiptare	1
Partia Socialdemokrate	1
Partia Demokratike	1

- Shpalljen e kandidatëve fitues nga listat shumëmemërore të subjekteve zgjedhore, të miratuara nga Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor, për Këshillin e Bashkisë Tepelenë, si më poshtë:

Bashkë Fitojmë

1. Marios Aljosa Jorgo

Partia Socialiste e Shqipërisë

1.	Dino	Ibrahim	Selimi
2.	Matilda	Maksim	Çela
3.	Besnik	Vahedin	Maça
4.	Marsela	Miltjadh	Balili
5.	Latif	Shyqo	Kaçaj
6.	Esmeralda	Hasko	Bishani
7.	Arben	Fejzo	Gumeni
8.	Mirela	Xhezmi	Varfi
9.	Miftar	Guxhë	Meta
10.	Mjaftoni	Rrapo	Zeraj
11.	Ilir	Gëzim	Haska

Partia Republikane Shqiptare

1.	Ditar	Halil	Hodaj
----	-------	-------	-------

Partia Socialdemokrate

1.	Vladimir	Bejo	Gjonça
----	----------	------	--------

Partia Demokratike

1.	Vladimir	Baki	Bakiaj
----	----------	------	--------

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

Bashkia Tepelenë, herësit

Tabela nr. 2

NR_FV	SUBJEKTI	SIGLA	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	
1	Bashkë Fitojmë	BF	426	213	142	106	85	71	60	53	47	42	38	35	H e r ë s i t
2	Partia Socialiste e Shqipërisë	PS	2680	1340	893	670	536	446	382	335	297	268	243	223	
3	Partia Agrare Ambientaliste e Shqipërisë	P.A.A	185	92	61	46	37	30	26	23	20	18	16	15	
4	Partia Republikane Shqiptare	PR	358	179	119	89	71	59	51	44	39	35	32	29	
5	Partia Levizja e Legalitetit	PLL	72	36	24	18	14	12	10	9	8	7	6	6	
6	Partia Demokracia Sociale	P.D.S	42	21	14	10	8	7	6	5	4	4	3	3	
8	Partia Socialdemokrate	PSD	400	200	133	100	80	66	57	50	44	40	36	33	
9	Partia Demokratike	PDSH	227	113	75	56	45	37	32	28	25	22	20	18	
12	Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet	P.D.I.U	44	22	14	11	8	7	6	5	4	4	4	3	
17	Aleanca Arbnore Kombëtare	AAK	189	94	63	47	37	31	27	23	21	18	17	15	
18	Partia Balli Kombëtar	P.B.K	150	75	50	37	30	25	21	18	16	15	13	12	
19	Aleanca për Demokraci dhe Solidaritet	ADS	137	68	45	34	27	22	19	17	15	13	12	11	